



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9094 Prot.

Lezhë, më 05 . 05 . 2021

VENDIM

Nr. 90 Datë 30 . 04 . 2021

PËR

PËR MIRATIMIN E KURSEVE, PAGESËS DHE KRITEREVE PËR MËSUESIT E
JASHTËM PËR KURSET QË DO TË ZHVILLOHEN PRANË QENDRËS KULTURORE
TË FËMIJËVE "GJERGJ LACAJ" LEZHË

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 1 dhe 2, ligjin nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" neni 28, pika 1 dhe 2, Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Lezhë "Mbi Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Lezhë dhe Njësive Administrative" dt.23.05.2018, neni 61, pikat 3 dhe 4 dhe neni 62, pika 7, VKM nr.175, datë 08.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa page të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar" pikat 1 dhe 2, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

- I. Miratimin e zhvillimit të kurseve për piano, kanto, balet, anglisht dhe pikturë pranë qendrës kulturore të fëmijëve "Gjergj Lacaj" Lezhë.
- II. Miratimin e pagesës së mësuesve të jashtëm:

Nr.	Kursi	Pagesë për orë	Orë/ muaj	Orë gjithsej	Totali
1.	Piano	275	37	296	81 400 lekë
2.	Kanto	275	37	296	81 400 lekë
3.	Balet	275	37	296	81 400 lekë
4.	Anglisht	275	37	296	81 400 lekë
5.	Pikturë	275	37	296	81 400 lekë
Shuma			185	1480	407 000 lekë

- III. Miratimin e kritereve që duhet të plotësojë mësuesi i jashtëm:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë.
- f. Të ketë mbaruar studimet në fushën përkatëse sipas llojit të kursit, të paktën në nivelin Bachelor.
- g. Të kenë aftësi të mira komunikuese me fëmijët dhe të punës në grup.

IV. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

